



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:101431

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05451045

C.nr.228/16

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Mirjeta Shala në çështjen juridike të paditëses A.D., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit përfaqëson Korab Bokshi, avokat në Gjakovë, ndaj të paditurve I.D., D.D., , Sh.D., dhe D.D që të gjithë nga Gjakova, rr. “Ilir Soba” numër 3., me objekt kontesti për vërtetimin e drejtës së pronësisë në paluajtshmeri, me datë 14 mars 2024 morri këtë

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia me numër C.nr.228/16e ushtruar me datën 10.05.2019 nga paditësja A.D., nga Komuna e Gjakovës, ndaj të paditurve I.D., D.D., , Sh.D., dhe D.D nga Gjakova, në çështjen juridike për vërtetimin e drejtës së pronësisë në paluajtshmeri.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë me datën 10.05.2019 kanë ushtruar padi ndaj të paditurve I.D., D.D., , Sh.D., dhe D.D nga Gjakova, për për vërtetimin e drejtës së pronësisë në paluajtshmeri.

I autorizuari i paditëses në këtë Gjykatë me date 15.02.2024 ka dorëzuar parashtrësë për tërheqje të padisë duke e konstatuar se kjo çështje kontestimore ishte iniciuar për shkak të paditësja A.D., nuk ishte përfshirë në si trashëgimtarë e babait të saj A.D, tash i ndjerë, ka shtuar se ndërkohe nga paditësja është njoftuar që çështja kontestimore mes palëve ndërgjyqësve është zgjidhur në procedure jashtgjyqësore, andaj çështja mbetet pa objekt të kontestit dhe për këtë arsye ka kërkuar tërheqjen e padisë.

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 261 par.2 të Ligjit Nr.03/L-006(tutje :LPK), erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditëse të konstatohet e tërhequr, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, konform nenit 261 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

- Departamenti i Përgjithshëm -

C.nr. 228/16, datë 14 mars 2024

Gj y q t a r j a,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261.4 të LPK-së, nuk lejohet ankesa.